

Enso Hydro Energji sh.p.k.

**Pasqyrat Financiare sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

Përbajtje

Raporti i audituesit të pavarur	i
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e flukseve të parasë.....	4
 1. Informacion i përgjithshëm	5
2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare	5
3. Politikat kontabël	6
4. Standardet e reja të kontabilitetit dhe interpretimet e tyre	10
5. Mjetet monetare dhe ekuivalente	12
6. Aktive të tjera afatshkurtra	12
7. Llogari të arkëtueshme	13
8. Investimet ne filiale	13
9. Hua të arkëtueshme	13
10. Aktive afatgjata materiale	14
11. Llogari të pagueshme	14
12. Detyrime të tjera	14
13. Huatë	14
14. Kapitali i paguar	15
15. Të ardhurat	15
16. Shpenzime të personelit	15
17. Shpenzime të veprimtarisë	15
18. Të ardhura dhe shpenzime financiare	15
19. Tatimi mbi fitimin	16
20. Palë të lidhura	16
21. Angazhime dhe detyrime e të drejta të kushtëzuara	17
22. Menaxhimi i riskut financiar	17
23. Ngjarje pas periudhës së raportimit	18

Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar Aksionarëve të Enso Hydro Energi sh.p.k

Opioni ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin, në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financier të Enso Hydro Energji sh.p.k ("Shoqëria") më 31 dhjetor 2016, si dhe performancën e saj financiare dhe fluksset e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri ("SKK").

Ne kemi audituar:

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përfshijnë:

- pasqyra e pozicionit financier më 31 dhjetor 2016;
- pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyra e fluksave të parasë për vitin e mbyllur në atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë një përbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" në këtë raport.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën e opinionit tonë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistikës të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"), të cilat janë të zbatueshme në auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri. Ne kemi përbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi i Shoqërisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK, dhe për kontrolllet e brendshme, të cilat Drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmérinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen e shoqërisë janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit finansiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përbajnjë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një gabim material. Gabimet mund të vijnë si rezultat i mashtimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimit material në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një gabim material si rezultat i mashtimit është më i lartë sesa një gabim si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- sigurojmë kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm të auditimit, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shenimeve shpjeguese të përgatitura nga Drejtimi.
- japim përfundime mbi përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga Drejtimi dhe bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri të materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e shoqërisë për të vjuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të térheqim vëmendjen në reportin tonë të audituesit në lidhje me shenimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shenimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Shoqërisë.
- vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shenimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që siguron paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, ndërmjet të tjera, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontolleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k
Tiranë, Shqipëri
24 prill 2017




Auditues ligjor
Laureta Peci Kellici

Enso Hydro Energji sh.p.k.
Pasqyra e Pozicionit Financiar

Më 31 Dhjetor 2016

(shumat në Lekë, përvèç rasteve kur specifikohet ndryshe)

	Shënimë	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Aktivet			
Aktivet afatshkurtra			
Mjete monetare	5	41,843,954	3,552,826
Aktive të tjera afatshkurtra	6	1,131,744	16,584,068
Llogari të arkëtueshme	7	6,003,632	13,088,684
Hua të arkëtueshme	9	232,706,459	149,220,777
Totali i aktiveve afatshkurtra		281,685,789	182,446,355
Aktivet afatgjata			
Investime	8	1,346,776,749	1,346,776,749
Hua të arkëtueshme	9	1,590,797,096	1,543,801,520
Aktive afatgjata materiale	10	162,376	216,500
Totali i aktiveve afatgjata		2,937,736,221	2,890,794,769
Totali i aktiveve		3,219,422,010	3,073,241,124
Detyrimet dhe kapitali			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogari të pagueshme	11	7,759,260	5,833,195
Huamarje	13	24,516,727	16,975,518
Tatim fitimi i pagueshëm		-	4,297,789
Detyrime të tjera afatshkurtra	12	2,904,135	14,030,114
Totali i detyrimeve afatshkurtra		35,180,122	41,136,616
Detyrime afatgjata			
Huamarjet	13	548,852,071	411,840,000
Totali i detyrimeve afatgjata		548,852,071	411,840,000
Totali i detyrimeve		584,032,193	452,976,616
Kapitali			
Kapitali i paguar	14	2,612,737,000	2,612,737,000
Humbjet e akumuluara		7,526,876	(19,851,936)
Fitimi i vitit		15,125,941	27,379,444
Totali i kapitalit		2,635,389,817	2,620,264,508
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		3,219,422,010	3,073,241,124

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 18, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues i Enso Hydro Energji sh.p.k. më 27 Mars 2017, dhe janë firmosur në emër të tij nga:

Wolfgang Kröpfl / *Ulrike Krapinger*

Wolfgang Kröpfl dhe Ulrike Krapinger
Administratorë të përgjithshëm

Rezarta Kocollari / *Rezarta Kocollari*
Rezarta Kocollari / Rezarta Kocollari
Kontabiliste / Kontabiliste
00385 213 105217



Enso Hydro Energji sh.p.k.

Pasqyra e të ardhurava dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

(shumat në Lekë, përvèç rasteve kur specifikohet ndryshe)

	Shënimë	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Të ardhura	15	10,622,110	10,907,238
Shpenzimet			
Shpenzime të personelit			
Shpenzime pagë	16	(10,076,647)	(10,236,145)
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	16	(432,301)	(435,834)
Shpenzime të veprimtarisë	17	(6,690,337)	(7,656,824)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	10	(54,124)	(72,166)
Totali i shpenzimeve		(17,253,409)	(18,400,969)
Humbja nga veprimtaria kryesore		(6,631,299)	(7,493,731)
Të ardhura dhe shpenzime financiare			
Të ardhura nga interesë		69,377,574	82,920,366
Shpenzime interesë		(25,807,081)	(17,823,409)
Humbje nga kurset e këmbimit - neto	18	(18,740,576)	(25,042,586)
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare		24,829,917	40,054,371
Fitimi para tatimit		18,198,618	32,560,640
Tatimi mbi fitimin	19	(3,072,677)	(5,181,196)
Fitimi i vitit		15,125,941	27,379,444
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin		15,125,941	27,379,444

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 18 , të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Enso Hydro Energji sh.p.k.
Pasqyra e ndryshimeve në kapital

(shumat në Lekë, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

	Kapitali i paguar	Humbja e akumuluar	Fitimi i vitit	Totali
Gjendje më 1 janar 2015	2,612,737,000	(61,256,176)	41,404,240	2,592,885,064
Transferim i fitimit	-	41,404,240	(41,404,240)	-
Fitimi i vitit	-	-	27,379,444	27,379,444
Gjendje më 31 dhjetor 2015	2,612,737,000	(19,852,568)	27,379,444	2,620,263,876
Transferim i fitimit	-	27,379,444	(27,379,444)	-
Fitimi i vitit	-	-	15,125,941	15,125,941
Gjendje më 31 dhjetor 2016	2,612,737,000	7,526,876	15,125,941	2,635,389,817

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 18, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Enso Hydro Energji sh.p.k.

Pasqyra e flukseve të parës

(shumat në Lekë, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2015
Flukset monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitimi/(humbja) para tatimit		18,198,618	32,560,640
Rregullime për:			
Zhvlerësimin dhe amortizimin	10	54,124	72,166
Të ardhura nga interesi		-	(82,920,366)
Shpenzime interesi		25,807,081	17,823,409
Humbje operative përparrë ndryshimeve në kapitalin qarkullues			
Rënje/(Rritje) në aktive të tjera afatshkurtra	6	44,059,823	(32,464,151)
Rënje/(Rritje) në llogaritë e arkëtueshme	7	15,452,324	(11,011,318)
Rritje në llogaritë e pagueshme	11	7,085,052	(13,088,685)
(Rënje)/(Rritje) në detyrimet e tjera dhe tatim fitimin e pagueshëm		1,926,065	955,203
Fitim/(humbja) nga kurset e këmbimit	12	(15,423,768)	13,803,879
Flukset monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit			1,381,295
Parapagime të tatim fitimit		53,099,496	(40,423,777)
Interesi i paguar		(3,072,677)	(2,021,282)
Interesi i marrë		(25,807,712)	(17,823,409)
Flukset monetare neto nga/(përdorur në) veprimtaritë e shfrytëzimit		24,219,107	(60,268,468)
Flukset monetare nga veprimtaritë e investimit			
Huatë e disbursuara	13	(130,481,259)	(607,666,320)
Flukset monetare neto përdorur në veprimtaritë e investimit		(130,481,259)	(607,666,320)
Flukset monetare nga veprimtaritë e financimit			
Arkëtime nga huatë		144,553,280	428,815,518
Flukset monetare nga veprimtaritë e financimit		144,553,280	428,815,518
Rritje/(Rënje) e mjeteve monetare dhe ekuivalente		38,291,128	(239,119,270)
Mjetet monetare dhe ekuivalente në fillim të periudhës	5	3,552,826	242,672,096
Mjetet monetare dhe ekuivalente në fund të periudhës	5	41,843,954	3,552,826

Pasqyra e flukseve të parës duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 18, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Enso Hydro Energji sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shumat janë në Lekë, përvèç rasteve kur specifikohet ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Enso Hydro Energji sh.p.k. është një filial i zotëruar në masën 80% nga Enso Hydro GmbH, e cila është edhe shoqëria mëmë e grupit. Pjesa e mbetur prej 20% e kuotave të kapitalit zotërohen nga International Finance Corporation (IFC).

Shoqëria u themelua më 3 gusht 2011 dhe u regjistrua në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 17 gusht 2011 me numër identifikimi L12017010Q dhe seli në Tiranë, Shqipëri.

Aktiviteti kryesor. Veprimtaria kryesore e shoqërisë është ndërtimi, përdorimi, blerja dhe shitja e hidrocentraleve, prodhimi i energjisë elektrike dhe shitja e saj me shumicë për konsumatorët dhe distributorët.

Shoqëria realizon objektivat e saj duke themeluar një portofol të qëndrueshëm investimesh në hidrocentrale të vegjël e të mesëm. Shoqëria është krijuar për të përm bushur objektivat e Enso Hydro GmbH për investime të tillë në Shqipëri.

Enso Hydro GmbH investon në projekte centralesh elektrike, kryesisht nëpërmjet filialeve të huaja të krijuara posaçërisht në rajonet e synuara.

Filialet. Enso Hydro Energji sh.p.k ka blerë tre shoqëri të quajtura, Hasi Energji sh.p.k, Lengarica & Energy sh.p.k dhe Mati Hydropower sh.p.k.

Shoqëria zotëron 99.9% të kuotave të Lengarica & Energy sh.p.k. Kuotat e mbetur zotërohen nga Hasi Energji sh.p.k. Lengarica është një shoqëri e themeluar nga Hasi Energji sh.p.k për të përm bushur të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga një marrëveshje koncesioni me Ministrinë e Tregtisë dhe Energetikës së Republikës së Shqipërisë për ndërtimin e një hidrocentrali në Lengaricë-Petran, Përmet, Shqipëri. Për të përfituar pronësinë dhe kontrollin e plotë të Lengarica & Energy sh.p.k., shoqëria ka blerë 100% të aksioneve të Hasi Energji sh.p.k. i cili zotëron 1% të kuotave të Lengarica & Energy sh.p.k dhe është gjithashtu përgjegjëse ndaj Autoritetit Kontraktues për këtë marrëveshje koncesionare deri në momentin që hidrocentrali do të filloje punën.

Shoqëria gjithashtu zotëron 90% të kuotave të Mati Hydropower sh.p.k., i cili zotëron një marrëveshje koncesioni për ndërtimin e hidrocentraleve në lumin Mat, Mat, Shqipëri.

Hidrocentrali i Lengarica & Energy sh.p.k. u ndërtua në dhjetor 2015 me fuqi 8,906 kW energji elektrike, për prodhimin e energjisë elektrike prej 36,000,000 kW/h, ndërsa Hidrocentrali i Mati Hydropower sh.p.k. pritet të ketë një fuqi totale të instaluar prej 31,700 kW për prodhimin e 133,259,000 kW/h energji.

Të dyja marrëveshjet koncesionare janë përpiluar sipas formës BOT (Ndërtim, Operim dhe Transferim tek Autoriteti Kontraktues pas përfundimit të periudhës së koncesionit prej 35 vjetësh).

Administratorët e Përgjithshëm të shoqërisë janë Z. Wolfgang Kroepfl dhe Znj.Ulrike Krapinger.

Selia e regjistruar e shoqërisë është në rrugën Jul Variboba, Vila nr. 10,Tiranë, Shqipëri. Shoqëria është regjistruar si një entitet i tatueshëm me Zyrën Tatimore të Rrethit të Tiranës me numër identifikimi L12017010Q.

Numri i personelit më 31 dhjetor 2016 është 3 (31 dhjetor 2015: 3)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) te publikuara nga Keshilli Kombëtar i Kontabilitetit te miratura nga Ministria e Financave.

Këto janë pasqyrat financiare individuale të Enso Hydro Energji sh.p.k.. Shoqëria nuk përgatit pasqyra financiare të konsoliduara.

Nje shoqërie mëmë nuk i kërkohet të përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara në momentin që plotësohen këto dy kushte: (i) mëma është në vetvete një filial, dhe (ii) kur shoqëria mëmë e grupit (në këtë rast enso hydro GmbH) prodhon pasqyra financiare të konsoliduara me qëllim të përgjithshëm, që janë në përputhje me SNRF, ose me SNRF për SME-të.

Pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë dhe filialeve të saj konsolidohen në nivel gruji nga Enso Hydro GmbH, të cilat publikohen në faqen zyrtare të shoqërisë, <http://www.enso.at>

Enso Hydro Energji sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë (vazhdim)

Shoqëria mëmë– Enso Hydro GmbH – ka përgatitur pasqyrat financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF për shoqërinë dhe filialat e saj ('grupin'). Në pasqyrat financiare të konsoliduara, investimet në filiale – të cilat janë ato shoqëri në të cilat grupi, direkt ose indirekt, ka interes për më shumë se gjysmën e të drejtave të votës ose ndryshe ka fuqinë të ushtrojë kontroll mbi operacionet – janë konsoliduar plotësisht.

Përdoruesit e këtyre pasqyrave individuale financiarare duhet t'i lexojnë ato së bashku me pasqyrat financiare të konsoliduara të grupit për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2016 në mënyrë që të marrin një informacion të plotë mbi pozicionin financiar, rezultatet e operacioneve dhe ndryshimeve në pozicionin financiar të grupit si një i tërë.

2.2 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë. Aftësia e Shoqërisë për të vazduar përgatitjen e pasqyrave financiare sipas parimit të vijimësisë varet nga implementimi i suksesshëm i projekteve të filialeve të saj, Mati Hydropower sh.p.k dhe Lengarica & Energy sh.p.k. Mati Hydropower shpk eshte duke vazduar me fazën fillestare të ndërtimit në përputhje me planet e biznesit dhe pritet të fillojë prodhimin në 2017, ndersa Lengarica & Energy sh.p.k. ka filluar prodhimin dhe shitjen ne Dhjetor 2015. Gjithashtu, shoqëria po mban një raport te vogël borxh/kapital.

Drejtimi i Shoqërisë beson se pasqyrat financiare duhet te pregeten ne perputhje me parimin e vijimesise.

2.3 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare paraqiten në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë, monedha kryesore e mjedisit ekonomik në të cilin shoqëria kryen aktivitetin e saj.

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet përkatëse rishikohen në mënyrë të vazdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken nga këto rishikime.

Në veçanti, informacioni në lidhje me fushat më të rëndësishme të vlerësimeve, pasigurisë dhe gjykimeve në zbatimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të konsiderueshëm ndaj shumave të njoitura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke pasur parasysh thjeshtësinë e natyrës së veprimeve së shoqërisë.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në periudhat e paraqitura, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit.

Enso Hydro Energji sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

Fitimi ose humbja nga këmbimi i zërave monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurset e ndryshme përkatëse të këmbimit.

Të aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehën në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Monedha Euro (e cila është monedha kryesore me të cilën operon shoqëria) u konvertua me kursin 135.23 (2015: 137.28) Lekë.

3.2 Instrumente financiarë

Instrumentet financiarë joderivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

Instrumentet financiarë joderivativë nijhen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksi me lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentet e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Pas njohjes fillestare instrumentet financiarë joderivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument finansiar nijhet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit finanziar ose kur shoqëria transferon aktivin finanziar tek një palë e tretë pa mbajtur në thelb kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përfitimet e aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, e cila është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjete monetare dhe ekuivalente

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtër me bankat të cilat fillimisht nijhen me vlerën e drejtë dhe më vonë maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit të tyre.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme nijhen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigioni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme përllogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha të drejtat sipas kushteve të tyre fillestare. Vështirësitet financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij finansiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme janë të mbivlerësuara. Shuma e provigionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara monetare të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme nijhen me vlerë të drejtë dhe maten më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Huamarjet

Huamarjet nijhen fillimisht me vlerë të drejtë minus kostot e transaksionit që kanë ndodhur dhe maten më pas me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Të tjera

Instrumente të tjerë finansiarë joderivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Vlera e drejtë

Vlera e drejta e përllogaritura të mjeteve monetare, të kërkeshave për t'u arkëtar, detyrimeve për t'u paguar, huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Enso Hydro Energji sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shumat janë në Lekë, përvëç rasteve kur specifikohet ndryshe)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.3 Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtime në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur zbatohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto njihen neto në "të ardhura të tjera" në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve afatgjata jomateriale dhe përmirësimeve të ambienteve të marra me qira llogaritet duke përdorur metodën lineare të amortizimit ndërkohë për aktivet e tjera afatgjata materiale amortizimi llogaritet duke përdorur metodën e vlerës se mbetur përgjatë jetës së dobishme duke filluar nga dita e parë e muajit pas atij të blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet.

Jetëgjatësia e dobishme e vlerësuar për periudhën aktuale dhe metoda reciproke e amortizimit është si më poshtë:

Kategoritë	Metoda e amortizimit	Norma amortizimit
Pajisje informatike dhe të tjera	Vlera e mbetur	20% - 25%

Metoda e amortizimit,jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 Zhvlerësimi

(i) Aktivet financiare

Një aktiv finansiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin finansiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo humbje e akumuluar lidhur me një aktiv finansiar i disponueshëm për shitje i njohur më parë në kapital, transferohet në fitime ose humbje.

Enso Hydro Energji sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.4 Zhvlerësimi (vazhdim)

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Aktivet jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provigjonet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provigjonet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.7 Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesit nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit. Të ardhurat nga interesit njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesit mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv .

3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për tu paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatile të miratuar gjatë periudhës.

Enso Hydro Energji sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

4. Standardet e reja të kontabilitetit dhe interpretimet e tyre

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit të Shqipërisë ka nxjerrë disa ndryshime të standardeve ekzistuese të cilat janë miratuar nga Ministria e Financave më 22 Korrik 2014. Standardet e ndryshuara janë të detyrueshme për vitin që fillon më 1 Janar 2015 ose më vonë.

SKK 1 "Kuadri i Përgjithshëm për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare" (i ndryshuar)

Standardi i ri prezanton konceptin e të ardhurave gjithëpërfshirëse (të ardhurat dhe fitimet e realizuara dhe ato të parealizuara gjatë periudhës);

Një kërkesë për shënime shpjeguese është përfshirë në lidhje me ngjarjet që nuk rregullohen pas periudhës së raportimit në mënyrë që të përputhen me kërkesat e SNRF për NVM: "Një entitet duhet të paraqesë informacionet e mëposhtme për çdo kategori të ngjarjeve që nuk rregullohen pas periudhës së raportimit: (a) natyrën e ngjarjes, (b) vlerësim të efektit financiar të saj apo një arsy pse një vlerësim i tillë nuk mund të bëhet". Një ndër termat që ndryshon në të gjitha standardet është termi "pasiv" sepse në literaturën ndërkontabilitetit, përfshirë SNRF për NVM, përdoret termi "detyrim".

Terminologjia dhe prezantimi i pasqyrave financiare pritet të ndikohet nga ndryshimet e këtij standardi.

SKK 2 "Paraqitja e pasqyrave financiare" (i ndryshuar)

Sipas SKK 2 terminologjia dhe përkufizimet pësojnë ndryshime, por që nuk prekin thelbin e konceptit. Më specifiksht, ndryshojnë emëritimet për pasqyrat financiare sipas SNRF për NVM, konkretisht bilanci emërtohet pasqyra e pozicionit financiar, PASH emërtohet pasqyra e performancës financiare që përfshin edhe pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Koncepti i vijimësisë sqarohet më në detaje në përputhje me SNRF sipas NVM paragrafi 3.9 sipas të cilës shoqëria duhet të paraqesë pasiguri materiale të cilat hedhin dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e shoqërisë për të vazduhar me parimin e vijimësisë. Nëse shoqëria nuk përdor parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare, kjo e fundit duhet të paraqesë parimin mbi të cilin përgatiten parsqyrat financiare dhe arsyen pse parimi i vijimësisë nuk përdoret. SKK2 prezanton disa kërkesa të reja sipas paragrafëve 5.4/5/6 të SNRF për NVM jashtë kërkesat për paraqitjen e pasqyrës së vetme të tëardhurave gjithëpërfshirëse. SKK-të e përmirësuara tani e kanë pjesë të tyre konceptin e monedhës funksionale sipas paragrafit 7.12 i SNRF për NVM por kërkohë një amendim ligjor që edhe ligji i kontabilitetit të njoftë përdorimin e monedhës funksionale. Tashmë ka paragraf të posaçëm që udhëzon për rubrikën në pasqyrën e pozicionit financiar ku duhet të paraqiten dividendët dhe interesat e paguar në pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë pritet të reflektojnë ndryshimet në terminologji, zërat e pasqyrave financiare kryesore dhe prezantimin e tyre dhe informacionin shtesë ne lidhje me deklaratën e pajtueshmërisë dhe bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare.

SKK 3 "Instrumentet financiare" (i ndryshuar)

SKK3 është ndryshuar për tu përputhur me paragraplin 11 të SNRF për NVM. Fusha e zbatimit të SKK3 është ngushtuar vetëm për instrumentet e thjeshta financiare, sipas sektionit 11 të SNRF për NVM. Modeli i vlerësimit të mëpasshëm të instrumenteve financiare është vetëm ai i kostos së amortizuar, nuk lejohet më modeli i vlerës së drejtë. Koncepti i matjes fillestare të instrumenteve financiare jepet më i qartë në formulimin sipas SNRF për NVM dhe shënimet shpjeguese janë thjeshtuar.

SKK 4 "Inventarët" (i ndryshuar)

Sipas SKK 4 nuk përdoret më termi 'vlera neto e realizueshme' por thjesht përkufizimi i plotë i saj, që është i njëjtë me atë të dhënë në SNRF për NVM: "shoqëria duhet të masë inventarët me koston më të ulët midis çmimit të shitjes minus kostos për tu pëfunduar dhe shitur". SKK4 parashikon trajtimin kontabël të blerjeve të inventarëve në kushtet e pagesave të shtyra në afate.

Shoqëria parashikon se adoptimi i këtyre standarteve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë për periudhën e aplikimit filletar.

Ndryshimet e këtij standardi nuk priten të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Enso Hydro Energji sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

4. Standardet e reja të kontabilitetit dhe interpretimet e tyre (vazhdim)

SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale” (i ndryshuar)

SKK5 prezanton ndryshime që ndikojnë temat e mëposhtme:

Përkufizimi i kostove të huamarries bëhet sipas SNRF për NVM, sipas të cilët kostot e huamarries janë interest apo kosto të tjera me të cilat shoqëria përballet në raste të huamarrjeve. Kostot e huamarrjeve përfshijnë: shpenzime të interesit të llogaritura sipas metodës së interest efektive të pëershkuar në Paragrafin 11: Instrumentet Financiarë të thjeshtë b) shpenzimet financiare në lidhje me qiratë financiare të njohura në përputhje me Paragrafin 20 Qiratë c) ndryshimet nga kurset e këmbimit si pasojë e huamarrjeve në monedhë të huaj në masën që ato trajtohen si rregullim i shpezimeve të interesit.

Për më tepër, shpenzimet e zhvillimit dhe shpenzimet e interesit (kostot e huamarries) trajtohen si shpenzime periudhe, sipas SNRF për NVM dhe nuk mund të kapitalizohen.

Sipas SKK5, shtohet trajtimi kontabël për aktivet afatgjata materiale të investuara si dhe për pjesët e këmbimit dhe pajisjet e tyre, për rastet kur ato trajtohen si aktive afatgjata materiale. Ka më shumë kërkesa dhe udhëzime lidhur me përcaktimin e jetës së dobishme dhe llogaritjes së amortizimit për të dyja llojet e aktiveve, materiale dhe jomateriale dhe për njohjen e një aktivi afatgjatë jomaterial. Emri i mirë amortizohet për 10 vite sipas SNRF për NVM pra nuk testohet për zhvlerësim.

SKK 6 “Provizonet, aktivet dhe pasivet e kushtëzuara” (i ndryshuar)

Matja e provizioneve trajtohet më e detajuar sipas SNRF për NVM si dhe kërkon më shumë shënime shpjeguese lidhur me provizonet, aktivet dhe pasivet e kushtëzuara. Paragrafët 37-39 të SKK6 që mbulonin provizonet për pensionet, janë hequr.

Ndryshimet e këtij standardi nuk priten të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

SKK 7 “Kontabilizimi i qirave” (i ndryshuar)

Implementimi i përditësuar i SKK 7 është më i kufizuar duke qënë se disa janë prezantuar disa përjashtime nga qëllimi original.

SKK 8 “Të ardhurat” (i ndryshuar)

SKK 8 ka udhëzim të veçantë për matjen e arkëtimeve të shtyra në kohë dhe udhëzime më të thjeshta dhe të detajuara për metodën e fazës së përfundimit. SKK 8 e ndryshuar ka një organizim më mire, referuar ndarjes së qartë të udhëzimeve për shitjen e mallrave, ofrimin e shërbimeve, kontrata e ndërtimit dhe metodën e fazës së përfunduar. Për më tepër, ka udhëzime për format e reja të shfaqura të të bërit biznes, siç është p.sh, rasti i lëshimit të kartave të besnikërisë për klientët. Në përgjithësi, përkufizimet janë më të zgjeruara, tashmë janë sipas SNRF për NVM.

SKK 9 “Kombinimet e bizneseve” (i ndryshuar) dhe SKK 14 “Trajtimi kontabël i shoqërive të kontrolluara dhe pjesëmarrjeve” (i ndryshuar)

SKK 9 ka pësuar një numër ndryshimesh. Vërehet një ndarje e qartë mes çështjeve të kombinimit të bizneseve dhe atyre të investimeve në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta dhe shtohet një përkufizim për ‘njësitë ekonomike me qëllim të veçantë’. Kërkesa të reja janë prezantuar për (a) përkufizimin e termin kombinim biznesi (b) trajtimin kontabël të konsolidimit të pasqyrave financiare. Ka udhëzime për pasqyrat financiare të kombinuara ashtu si është parashikuar në paragrafët përkatës të SNRF për NVM ndërsa aplikimi i metodës së përshtatur të blerjes së njësive ekonomike që janë në kontroll të përbashkët nuk është më i lejuar. Një blerësi në një kombinim biznesi nuk i kërkohet më të bëjë analiza të vështira të çmimit të blerjes dhe ndryshe nga varianti I mëparshëm ku emri i mire amortizohet, nuk kërkohet më testi i zhvlerësimit për emrin e mire. Tashmë, lejohet përdorimi i vlerës së drejtë për investimet në pjesëmarrje ashtu si në SNRF për NVM.

Në vijim, ka kërkesa të veçanta për rastet kur shoqëria mëmë është e lejuar të mos përgatisë pasqyrat financiare të konsoliduara, të cilat nuk ishin më përparrë. Shoqëria mëmë është e lejuar të mos përgatisë pasqyrat financiare kur:

(a) Të dy kushtet e mëposhtëm plotësohen

- a. Shoqëria mëmë është filial, dhe
- b. Shoqëria mëmë përgatit pasqyrat financiare të konsoliduara për qëllime të përgjithshme të cilat janë në përputhje me SNRF për NVM.

Enso Hydro Energji sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

4. Standardet e reja të kontabilitetit dhe interpretimet e tyre (vazhdim)

(b) Nuk ka filiale përveç atyre të cilat janë blerë me qëllim për t'u shitur brenda një viti. Shoqëria mëmë duhet të njoftë një filial të tillë:

- Me vlerën e drejtë dhe ndryshimet e vlerës së drejtë duhet të paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, nëse vlera e drejtë e aksioneve mund të matet në mënyrë të besueshme, ose
- Me kosto minus zhvlerësimin.

Ndryshimet e këtij standardi priten të kenë një ndikim material në pasqyrat e Shoqërisë. Shoqëria nuk përgatit pasqyra financiare të konsoliduara sepse përbush kushtet e mësipërme të pikës (a).

SKK 10 “Grantet dhe format e tjera të ndihmës” (i ndryshuar)

Kërkosat e SKK 10 të përmirësuar janë ndryshuar pasi nuk parashikon më llojet e granteve të ndara në grante në para apo aktive të tjera materiale dhe jo materiale dhe kusht për njoftjen e grantit në të ardhura është vetëm plotësimi i performancës duke mos marrë në konsideratë amortizimin e aktivit material apo shpenzimet për t'u përballuar nga granti i marrë.

SKK 11 “Tatimi mbi fitimin” (i ndryshuar)

SKK 11 është standard i detyrueshëm si SKK-të e tjera. Në të ka paragafë të rinj që në mënyrë të posaçme mbulojnë trajtimin kontabël të tatim fitimit aktual dhe tatim fitimit të shtyrë. Janë hequr udhëzimet për njoftjen e aktiveve dhe detyrimeve tatimore për rastet e kombinimeve të bizneseve dhe aktiveve që mbahen me vlerë të drejtë.

SKK 12 “Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimeve” (i ndryshuar)

SKK 12 prezanton disa udhëzime të reja për konceptin e monedhës funksionale dhe rrjedhimisht të mjesdit ekonomik primar. Në këtë logjikë, jepen udhëzime për rastet kur monedha raportuese është e ndryshme nga monedha funksionale dhe prezanton udhëzime për investimet në një njësi ekonomike të huaj.

SKK 13 “Aktivet biologjike” (i ndryshuar)

Fusha e zbatimit të këtij standardi të përmirësuar përfshin edhe marrëveshjet koncessionare dhe lejon modelin alternativ atë të vlerës së drejtë nëse kjo e fundit gjendet lehtësisht pa kosto shtesë.

Ndryshimet e këtij standardi nuk priten të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

5. Mjetet monetare dhe ekuivalente

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Arka	88,883	126,251
Banka në Lekë	1,230,361	206,060
Banka në Euro	40,524,710	3,220,515
Totali	41,843,954	3,552,826

Mjetet monetare ne bankë janë ne Euro më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015 janë në Raiffeisen Bank Albania grupi i së cilës (Raiffeisen International AG) është klasifikuar A-2 nga S&P.

6. Aktive të tjera afatshkurtra

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Aktive të tjera afatshkurtra	1,131,744	16,584,068
Totali	1,131,744	16,584,068

Enso Hydro Energji sh.p.k.

Shënimë shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shumat janë në Lekë, përvëç rasteve kur specifikohet ndryshe)

7. Llogari të arkëtueshme

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Llogari të arkëtueshme	6,003,632	13,088,684
Totali	6,003,632	13,088,684

8. Investimet ne filiale

Filialet	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015	Pronësia ne %
Hasi Energji sh.p.k.	63,162,220	63,162,220	100.0
Lengarica & Energy sh.p.k.	864,466,529	864,466,529	99.9
Mati Hydropower sh.p.k.	419,148,000	419,148,000	90.0
Totali	1,346,776,749	1,346,776,749	

Gjatë 2016, nuk ka pasur ndryshime në strukturën e investimeve.

9. Hua të arkëtueshme

Gjate viteve 2016 dhe 2015 Shoqëriai ka dhëne huate e meposhtme filialeve te saj.

Huamarrës	Shuma e huasë në monedhe origjinale	Data e huasë	Shuma e huasë në ALL'000	Interesi i përllogaritur në ALL'000	Totali në ALL '000 2016	Shuma e huasë në ALL'000	Interesi i përllogaritur në ALL'000	Totali në ALL '000 2015
Lengarica & Energy sh.p.k.	1,000,000	18.07.13	135,230	31,325	166,555	137,280	24,250	161,530
	300,000	25.10.13	40,569	8,587	49,156	41,184	6,452	47,636
	140,000	02.10.13	18,932	3,980	22,912	19,219	2,983	22,202
	4,000,000	04.11.13	540,920	109,000	649,920	549,120	80,450	629,570
	100,000	12.06.15	13,523	1,250	14,773	13,728	514	14,242
	1,111,140	03.07.15	150,259	13,264	163,523	152,537	5,075	157,612
Nëntotal	6,651,140		899,433	167,406	1,066,839	913,068	119,724	1,032,792
Mati Hydropower sh.p.k.	500,000	13.01.14	67,615	11,649	79,264	68,640	8,919	77,559
	100,000	14.04.14	13,523	2,094	15,617	13,728	1,544	15,272
	350,000	13.05.14	47,331	7,065	54,396	48,048	5,121	53,169
	200,000	02.09.14	27,046	3,457	30,503	27,456	2,346	29,802
	90,000	19.12.14	12,171	1,303	13,474	12,355	799	13,154
	25,000	09.02.15	3,381	324	3,705	3,432	187	3,619
	3,200,000	26.02.15	432,736	37,115	469,851	439,297	20,191	459,488
	100,000	10.06.15	13,523	912	14,435	13,728	615	14,343
	25,000	04.11.15	3,381	135	3,516	3,432	28	3,460
	4,500	15.12.15	609	19	628	618	1	619
	10,000	14.01.16	1,352	39	1,391	-	-	-
	110,000	12.02.16	14,875	399	15,274	-	-	-
	180,000	14.04.16	24,341	526	24,867	-	-	-
	50,000	03.08.16	6,762	84	6,846	-	-	-
	18,000	19.09.16	2,434	21	2,455	-	-	-
	150,000	28.09.16	20,284	158	20,442	-	-	-
Nëntotal	5,112,500		691,364	65,300	756,664	630,734	39,751	670,485
Totali	11,763,640		1,590,797	232,706	1,823,503	1,543,802	159,475	1,703,277

Huatë dhënë Shoqërisë Lengarica&Energy sh.p.k janë të varuara nga pagesa e plotë e detyrimeve sipas Kontratës së Huamarrjes së Lengarica &Energy sh.p.k me huamarrësit Green for Growth Fund dhe Oesterreichische Entwicklungsbank. Huate e dhëna nga Enso për Lengaricën janë të pagueshme pas pagesës së këstit të fundit të kredisë, i cili daton më 15 qershor 2028. Huatë dhënë Mati Hydropower janë të ripagueshme pas gjashtë muajsh nga momenti që hidrocentrali fillon prodhimin.

Enso Hydro Energji sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shumat janë në Lekë, përvèç rasteve kur specifikohet ndryshe)

10. Aktive afatgjata materiale

	Pajisje kompjuterike dhe pajisje të tjera
Kosto	
1 janar 2015	402,169
Shtesa	-
31 dhjetor 2015	402,169
Shtesa	-
31 dhjetor 2016	402,169
Amortizimi	
1 janar 2015	(113,503)
Amortizimi i vitit	(72,166)
31 dhjetor 2015	(185,669)
Amortizimi i vitit	(54,124)
31 dhjetor 2016	(239,793)
Vlera neto kontabël	
31 dhjetor 2015	216,500
31 dhjetor 2016	162,376

11. Llogari të pagueshme

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Llogari të pagueshme	7,759,260	5,883,195
Totali	7,759,260	5,883,195

Furnitorët konsistonjë kryesisht në shërbimet e konsulencave ligjore dhe konsulencave të tjera të papaguara në datën e raportimit

12. Detyrime të tjera

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Detyrime të tjera	578,916	12,119,494
Detyrime për tatimin në burim	1,590,155	894,852
Detyrime për pagat e personelit	312,489	587,417
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat	334,327	339,603
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	88,248	88,748
Totali	2,904,135	14,030,114

13. Huatë

	31 dhjetor 2016		31 dhjetor 2016	
	Shuma e huasë në ALL'000	Interesa të përllogaritur në ALL'000	Shuma e huasë në ALL'000	Interesa të përllogaritur në ALL'000
Enso hydro GmbH	548,852,071	24,516,727	411,840,000	16,975,518
Total	548,852,071	24,516,727	411,840,000	16,975,518

Huatë përfshijnë huatë e marra nga enso hydro GmbH. Norma e interesit të aplikuar mbi huatë e marra gjate vitit 2016 është 5.5%.

Enso Hydro Energji sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

14. Kapitali i paguar

Në datën e raportimit, kapitali i nënshkruar përbëhet nga 26,127,370 kuotave me vlerë nominale Lek 100 për kuotë. 80% e kuotave zotërohen nga enso hydro GmbH dhe 20% nga International Finance Corporation Gjate vitit 2016 nuk ka patur ndryshime ne kapitalin e paguar.

	Nr. i Kuotave te enso hydro GmbH	Nr. i Kuotave te IFC	Vlera Nominale ne Lek
1 janar 2015	20,901,896	5,225,474	2,612,737,000
31 dhjetor 2015	20,901,896	5,225,474	2,612,737,000
31 dhjetor 2016	20,901,896	5,225,474	2,612,737,000
Në %	80%	20%	100%

15. Të ardhurat

Shoqëria gjeneron të ardhura nga interesat dhe tarifat e aplikuara ndaj Mati Hydropower sh.p.k dhe Lengarica&Energy sh.p.k

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura	10,622,110	10,907,238
Totali	10,622,110	10,907,238

16. Shpenzime të personelit

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
Pagat e personelit	10,076,647	10,236,145
Shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	432,301	435,834
Totali	10,508,948	10,671,979

17. Shpenzime të veprimtarisë

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
Konsulentë financiare dhe shpenzime auditimi	2,214,150	1,256,320
Konsulencë ligjore	753,198	4,558,530
Shpenzime përfaqësimi	571,527	84,168
Shpenzime transporti	214,209	41,750
Qira zyre	293,735	298,500
Të tjera	175,291	724,182
Shpenzime administrative	99,748	424,158
Taksa të tjera	63,000	18,120
Shpenzime të tjera për konsulencë	2,305,479	216,796
Shpenzime përkthimi	-	34,300
Totali	6,690,337	7,656,824

18. Të ardhura dhe shpenzime financiare

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
Te ardhura nga kursi i këmbimit	14,328,420	514,484
Humbje nga kursi i këmbimit	(33,068,996)	(25,557,070)
Totali	(18,740,576)	(25,042,586)

Enso Hydro Energji sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shumat janë në Lekë, përvëç rasteve kur specifikohet ndryshe)

19. Tatimi mbi fitimin

Bazuar në legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 është 15% (2015 :15%).

Deklaratat timore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që autoritetet timore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat timore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet timore.

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015
Fitimi/(Humbja) e vitit	18,198,618	32,560,640
Vlera teorike e aplikueshme me normën e tatim fitimit statutor	15%	2,729,793
Efekti tatiomor i zérave që nuk janë të zbritshëm ose të vlerësueshëm për qëllime tatimore		
- Shpenzimet e panjohura	15%	342,884
Shpenzim i tatim fitimit	15%	3,072,677

20. Palë të lidhura

Gjatë kryerjes së veprimtarisë së biznesit, shoqëria kryen transaksione me palët e lidhura. Shoqëria kryen transaksione me shoqërinë mëmë të saj dhe me filialet e saj.

Balancat dhe transaksionet e Shoqërisë me palët e lidhura në datën e raportimit janë si më poshtë:

	Marrëdhënia	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Aktive			
<u>Huamarrie</u>			
Lengarica & Energy sh.p.k.	Filial	1,066,839,960	1,029,511,576
Mati Hydropower sh.p.k.	Filial	756,663,596	670,485,787
<u>Llogari të arkëtueshme</u>			
Lengarica & Energy sh.p.k.	Filial	944,785	5,223,020
Mati Hydropower sh.p.k.	Filial	5,058,847	890,597
Detyrime			
<u>Huamarrie</u>			
enso hydro GmbH	Shoqëria mëmë	548,852,071	411,840,000
<u>Llogari të pagueshme</u>			
enso hydro GmbH	Shoqëria mëmë	-	16,975,518
Lengarica & Energy sh.p.k.	Filial	-	98,156
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve			
<u>Të ardhura të tjera</u>			
Lengarica & Energy sh.p.k.	Filial	6,580,481	10,165,070
Mati Hydropower sh.p.k.	Filial	4,041,629	742,168
<u>Shpenzime operacionale</u>			
enso hydro GmbH	Shoqëria mëmë		382,980
<u>Të ardhura interesit</u>			
Lengarica & Energy sh.p.k.	Filial	49,468,854	58,261,495
Mati Hydropower sh.p.k.	Filial	19,908,720	31,633,901
<u>Shpenzime interesit</u>			
enso hydro GmbH	Shoqëria mëmë	25,807,081	17,823,409

Enso Hydro Energji sh.p.k.

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shumat janë në Lekë, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe)

21. Angazhime dhe detyrime e të drejta të kushtëzuara

Detyrime të kushtëzuara ligjore

Gjatë kryerjes së veprimitarës së biznesit, shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, përfundimet e këtyre çështjeve nuk do të kenë ndikime të rëndësishme negative në pozicionin financier të shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Pasiguri në lidhje me tatimet

Legislacioni tatimor shqiptar në fuqi në fund të periudhës raportuese është subjekt interpretimesh të ndryshme kur zbatohet ndaj veprimeve dhe aktivitetit të shoqërisë. Rrjedhimisht, pozicioni tatimor i përcaktuar nga drejtimi dhe dokumentacioni formal i cili mbështet këtë pozicion mund të kundërshtohet nga autoritetet tatimore. Periudhat fiskale konsiderohen të hapura për rishikim të çështjeve tatimore nga autoritetet fiskale për tre vite kalendarike duke filluar nga viti para se të merret një vendim në lidhje me rishikimin. Në raste të caktuara, rishikimet mund të mbulojnë një periudhë më të gjatë.

Detyrimet e regjistruara në lidhje me pozicionin fiskal të shoqërisë janë përcaktuar nga drejtimi duke u bazuar në rezultatet më të mundshme në rast se përllogaritjet do të kryheshin nga autoritetet fiskale. Vlerësimi bazohet në interpretimet e legjisacionit tatimor që është në fuqi në fund të periudhës së raportimit dhe ndonjë vendim gjyqësor apo interpretim i njohur i autoriteteve. Detyrimet për penalitete, interesa dhe tatime të tjera përveç tatimit mbi të ardhurat njihen në bazë të vlerësimeve më të mira të drejtimit në lidhje me shpenzimet e nevojshme për të shlyer detyrimet në fund të periudhës së raportimit.

22. Menaxhimi i riskut finanziar

a. Risku i kredisë

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Mjete monetare	41,843,954	3,552,826
Llogari të arkëtueshme	6,003,632	13,088,684
Hua të arkëtueshme	1,823,503,555	1,693,022,297
Totali	1,871,351,141	1,709,663,807

b. Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është rishku me të cilin shoqëria do hasë vështirësi në ngritjen e fondevës përmes përbushur angazhimet që lidhen me instrumentet financiare. Kompania monitoron likuiditetin e saj në baza periodike në mënyrë që të menaxhojë detyrimet e saj, si dhe kur ato maturohen.

Tabelat e mëposhtme të likuiditetit janë hartuar duke u bazuar në maturimet kontraktuale të paskontuara te aktiveve dhe detyrimeve financiare.

31 dhjetor 2016	Më pak se 1 muaj	Nga 1 muaj në 1 vit	Nga 1 deri në 5 vjet	Totali
Llogari të arkëtueshme	6,003,632	-	-	6,003,632
Hua të arkëtueshme	-	232,706,459	1,590,797,096	1,823,503,555
Mjete monetare	41,843,954	-	-	41,843,954
Totali i aktiveve financiare	47,847,586	232,706,459	1,590,797,096	1,871,351,141
 Llogari të pagueshme	 7,759,260	 -	 -	 7,759,260
Huamarrje	-	24,516,727	548,852,071	573,368,798
Totali i detyrimeve financiare	7,759,260	24,516,727	548,852,071	581,128,058
Hendeku i likuiditetit më 31 dhjetor 2016	40,088,326	208,189,732	1,041,945,025	1,290,223,083

Enso Hydro Energji sh.p.k.

Shënimë shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(shumat janë në Lekë, përvèç rasteve kur specifikohet ndryshe)

22. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

31 dhjetor 2015	Më pak se 1 muaj	Nga 1 muaj në 1 vit	Nga 1 deri në 5 vjet	Totali
Llogari të arkëtueshme	3,552,826	-	-	3,552,826
Hua të arkëtueshme	-	149,220,777	1,543,801,520	1,693,022,297
Mjete monetare	13,088,684	-	-	13,088,684
Totali i aktiveve financiare	16,641,510	149,220,777	1,543,801,520	1,709,663,807
 Llogari të pagueshme	 5,833,195			 5,833,195
Huamarje		16,975,518	411,840,000	428,815,518
Totali i detyrimeve financiare	5,833,195	16,975,518	411,840,000	434,648,713
Hendeku i likuiditetit më 31 dhjetor 2016	10,808,315	132,245,259	1,131,961,520	1,275,015,094

c. Risku i kursit të këmbimit

Risku i kursit të këmbimit, është rishku se vlera e drejtë ose flukset monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të luhaten për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit. Shoqëria kryhen transaksione në monedhë të huaj që lidhen me aktivitetin financiar dhe operativ të saj. Shoqëria nuk përdor ndonjë instrument të veçantë për tu mbrojtur ndaj këtij rishku. Pjesa më e madhe e transaksioneve të shoqërisë është në Euro.

31 dhjetor 2016	EUR	ALL	Total
Aktivet financiare			
Mjete monetare	40,524,710	1,319,244	41,843,954
Llogari të arkëtueshme	-	6,003,632	6,003,632
Hua të arkëtueshme	1,823,503,555	-	1,823,503,555
Totali i aktiveve financiare	1,864,028,265	7,322,876	1,871,351,141

Detyrime financiare

Llogari të pagueshme	7,759,260	-	7,759,260
Huamarje	573,368,798	-	573,368,798
Totali i detyrimeve financiare	581,128,058	-	581,128,058
Pozicioni finansiar neto më 31 dhjetor 2016	1,282,900,207	7,322,876	1,290,223,083

31 dhjetor 2015

	EUR	ALL	Total
Aktivet financiare			
Mjete monetare	3,221,515	331,311	3,552,826
Llogari të arkëtueshme	-	13,088,684	13,088,684
Hua të arkëtueshme	1,693,022,297	-	1,693,022,297
Totali i aktiveve financiare	1,696,243,812	13,419,995	1,709,663,807

Detyrime financiare

Llogari të pagueshme	5,833,195	-	5,833,195
Huamarje	428,815,518	-	428,815,518
Totali i detyrimeve financiare	434,648,713	-	434,648,713
Pozicioni finansiar neto më 31 dhjetor 2015	1,261,595,099	13,419,995	1,275,015,094

23. Ngjarje pas periudhës së raportimit

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që kërkojnë rregullime apo shënime të tjera shpjeguese në këto pasqyra financiare.